

Pjesë nga libri

Reconciliation after Violent Conflict

International Institute for Democracy and Electoral Assistance, 2003.

autorët Mark Freeman dhe Pricilla B. Hayner

Përkthim i tekstit *What is Truth Commission?*

Çfarë është Komisioni për të Vërtetën

Në përgjithësi, “komisionet për të vërtetën” kanë të njëjtat karakteristika. Janë ngritur zyrtarisht nga viti 1974 të paktën 25 komisione zyrtare për të vërtetën anekënd botës. Ato bartnin emërtime të ndryshme. Në Argjentinë, Uganda dhe Sri Lankë ky mekanizëm quhej “Komisioni për të Zhdukurit”; në Haiti dhe në Ekuador ishte ky “Komisioni për të vërtetën dhe drejtësinë”; në Kili, Afrikën Jugore, Sierra Leone dhe tashmë në Republikën Federale të Jugosllavisë “Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin”, dhe së fundi në Timorin Lindor u ngritë “Komisioni për Pranimin, të Vërtetën dhe Pajtimin. Edhe pse të gjitha këto komisione përputhen me definicionin e dhënë më lartë, duhet të kihet parasysh se disa nga to në kohën kur ato operonin nuk e konsideronin vetën si komisione për të vërtetën dhe as që janë perceptuar kështu nga publiku më i gjerë.

1. Përparësitë Potenciale dhe Rreziqet

1.1. Përparësitë Potenciale

Edhe pse komisione për të vërtetën nganjëherë nuk janë të përshtatshme për çdo situatë, ato kanë potenciale që mund të prodhojnë shumë përparësi për shoqëritë në tranzicion. Lista e përparësive potenciale që do të ravigëzohet në vijim do të mund të asistonte në përcaktimin e fokusit dhe refleksioneve që do të mund të kihesh parasysh gjatë ngritjes apo të zhvillimit të një komisioni të tillë.

- **Komisioni do të mund të përcaktonte të vërtetën për të kaluarën.**

Ai do të mund të përshkruante të kaluarën në mënyrë të saktë, të detajuar, të pavarur dhe zyrtare. Një histori e tillë do të mund të shërbente për tu ballafaquar me trillime dhe ekzagjerime të së kaluarës që u propagandonin nga regjimi i mëparshëm (apo palët e tjera nga konfliktet e kaluara) dhe ndërgjegjes publike do të mund t’i afronte shkallën e vërtet e kaluarës së dhunshme dhe pasojat e saj. Rrjedhimisht, komisionet do të mund të përcaktojnë fatin e personave të pagjetur që “u zhdukën” në mënyrë të dhunshme apo u varrosen fshehtazi.

- **Komisionet për të vërtetën do të mund të promovojnë llogaridhënien të të gjithë atyre që i abuzuan të drejtat e njeriut.**

Ato mund të plotësojnë punën e prokurorëve për këto krime duke mbledhur, organizuar dhe ruajtur evidencën që është e vlefshme për procedim nga ana e prokurorisë. Ato, po ashtu, vetvetiu do të mund të krijojnë dhe rekomandojnë forma të veçanta të llogaridhënies për ata që nuk ndiqen penalisht sikundër përgjegjësi qytetare, largim nga detyra, punë të dobishme shoqërore.

- **Komisioni do të mund të krijonte një platformë publike për viktimat.**

Kjo do të mund të shërbente si ndihmë që viktimat - të cilat u injoruan gjatë apo u harruan nga publiku – të vihen në ballë dhe në qendër të procesit kalimtar nëpër të cilin po kalon shoqëria e caktuar. Kjo do të mund të ndihmonte që viktimat të ndjehen sërish si anëtarë të barabartë të shoqërisë si individë dhe si grup, sikurse të fitojnë ndjenjën e çlirimit personal. Rrjedhimisht, me sigurimin e platformës publike për viktimat që të ngritën dhe flasin me zërin e vetë, komisionet ndihmojnë në edukimin e publikut për ndikimin e krimeve të së kaluarës mbi raste individuale dhe në këtë mënyrë më pas të krijojnë kushte për përkrahjen e nismave të mëtutjeshme për drejtësi dhe në dobi të viktimitave sikundër programe reparacioni.

- **Komisioni do të mund të ndihmojë dhe të drejtojë debatin publik.**

Ai mund të ndihmojë në stimulimin e shqyrtimit publik të një game komplekse të çështjeve morale, politike e legale që duhet adresuar gjatë periudhës kalimtare. Kjo do të mund të arrihet me anë të inkuadrimin të publikut në aktivitetet e komisionit si dhe inkurajimit të mediave për të raportuar për këto. Rrjedhimisht, komisione për të vërtetën vetvetiu mund të shërbejnë si model për publikun kur ai fillon të ushtrojë qasje kritike në diskutimin e çështjeve të diskutueshme pa drojë nga ndonjë përndjekje apo përgjigje të dhunshme. Komisionet, gjithashtu, mund të shërbejnë si një arbitër i pavarur, i paanshëm dhe publik sidomos kur pjesëtarë të regjimit të mëparshëm i shtrembërojnë apo i keqinterpretojnë ngjarjet e së kaluarës.

- **Komisionet mund të rekomandojnë dëmshpërblimin e viktimitave.**

Ato mund të procedojnë raste konkrete për dëmshpërblim për shkak të abuzimeve të tyre në të kaluarën si dhe për lëndime aktuale psikike, fizike dhe ekonomike që i vuajnë ende viktimat. Ato, po ashtu, mund t'i vendosin definicione dhe kategori të drejta dhe efektive për “viktimat” me qëllim të dëmshpërblimit apo krijimit të përparësive të tjera për ta. Më tutje, komisionet do të mund të ndihmojnë në rimëkëmbjen e dinjitetit moral të viktimitave me anë të promovimit të punës në mënyrë e cila është njëherësh senzibiluese si dhe njëherësh që sakrifikuan viktimat. Komisionet, më tutje, do të mund të krijojnë sugjerime të qëlluara dhe kreative lidhur me format simbolike për dëmshpërblimin e viktimitave sikundër memoriale, rivarime dhe ceremoni komemorative.

- **Komisionet mund të rekomandojnë reformat e nevojshme legale e institucionale.**

Përmes hetimeve të tyre, ato mund të sigurojnë evidencën e qartë për atë se si institucionet konkrete, individualisht dhe kolektivisht, dështuan të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të kaluarën. Në të njëjtën vazhde, komisionet do të mund të identifikojnë dhe rekomandojnë reformat specifike legale dhe institucionale që do t'i ndihmonin vendit t'i arrinte objektivat e vetë të afatgjata sociale, ekonomike e politike që janë thelbësore për sigurimin e një të ardhme të më të mirë. Reforma të tilla, për shembull, do të mund të përbëhen prej fuqizimit të kontrollit civil mbi agjencitë informative apo ushtrinë; emërtimeve të reja dhe të përhershme në gjyqësorin si dhe rregullave disiplinuese për këtë lëmë; përcaktimit bashkëkohor të sistemit elektoral e politik; reformat e tokave si dhe programe për trajnimet e policisë dhe forcave të armatosura në fushën e të drejtave të njeriut.

- **Komisionet mund të promovojnë pajtimin.**

Ato mund të promovojnë tolerancën dhe mirëkuptimin duke u mundësuar palëve të konfrontuara të dëgjojnë për pakënaqësitë dhe vuajtjet e njëra tjetrës. Kjo do të mund të ndihmonte në krijimin e ndjenjës së përjetimit dhe rrjedhimisht të heqjes dorë nga

hakmarrja dhe kundërgoditjet të rivaleve, por edhe ngritjes së urrejtjes që bazohet në ngjarjet e së kaluarës. Komisionet, gjithashtu, mund të sigurojnë forume të sigurt dhe të paanshme për përsëritjen e proceseve të drejtësisë në të cilat viktime, abuzuesi dhe/apo individë të tjerë apo pjesëtarë të komunitetit do të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e ankesave të së kaluarës që kanë natyrë më serioze. Më tutje, komisionet mund të rekomandojnë masa të drejta dhe praktike për kthimin dhe integrimin e nevojshëm të disa kategorive të abuzuesve në shoqëri.

- **Komisionet do të mund të ndihmojnë në konsolidimin e tranzicionit demokratik.**

Duke i pasur parasysh të gjitha përparësitë që i sjellin ngritja dhe puna e komisioneve për të vërtetën, ato mund të ndihmojnë në ndarjen nga e kaluara e errët dhe e dhunshme, si dhe të ndihmojnë në tranzicionin e shoqërisë drejt një të ardhme paqësore e demokratike, më të ndritshme dhe më të hapur. Nëse ato janë të suksesshme, komisionet për të vërtetën mund të shkaktojnë efektin e dobësimit të faktorëve kundër-demokratik që mund të vazhdojnë të angazhohen për qëllime të tyre jashtë procesit demokratik.

1.2. Shkaqet përse komisionet për të vërtetën nuk janë përdorur gjithmonë

Ashtu si komisionet për të vërtetën kanë potencial për të bërë dhe sjellë shumë dobi për shoqëritë në tranzicion, komisionet për të vërtetën po ashtu kanë potencial për të prodhuar dëme. Në të vërtetë, me qëllim anashkalimin e dëmit, në kontekstin tranzitor në të cilin gjendeshin Spanja e viteve të 70-ta e deri te Kamboxhia në fillim të viteve të 80-ta dhe Mozambiku në vitin 1990 dhe më tutje, shoqëria civile dhe liderët demokratik politik nganjëherë dhe me vetëdije ishin kundër çdo përpjekjeje për të precizuar të vërtetën për të kaluarën në mënyrë formale. Hezitimi për inkuadrimit në çdo iniciativë për të përcaktuar të vërtetën zyrtare për të kaluarën në këto dhe raste të tjera, përgjithësisht duket se ishte bazuar mbi këto përcaktime:

- **Frika nga ripërtëritja apo shpërthimi i dhunës së re**

Ekziston një perceptim se dhuna sërish mund të shpërthejë, lufta do të mund të rikthehet apo lufta kurrë nuk do të përfundonte nëse adresohen krime të vjetra.

- **Konflikti aktual**

Ekzistimi i një komisioni për të vërtetën në kontekstin ku është duke u zhvilluar një konflikt intensiv i armatosur është sidomos i diskutueshëm sepse praktikisht do të jetë e pamundshme të fitohet dhe të ushtrohet paraqitja neutrale, apo të sigurohet inkuadrimit i viktimës dhe i dëshmitarëve si dhe siguria e tyre. Po ashtu, në një kontekst të tillë do të reduktoheshin qasja gjeografike si dhe ajo ndaj informacioneve vendimtare. Në të njëjtën kohë, madje edhe në mes të konfliktit, do të mund të ishte e dobishme të fillohet me propagandimin dhe planifikimin e projektit të kërkimit të së vërtetës i cili do të fillonte së implementuari nga fundi i konfliktit dhe në fillim të fazës kalimtare.

- **Mungesa e interesimit politik**

Në mesin e autoriteteve politike nuk ekziston interesi apo ai është i vogël për kërkim të së vërtetës. Po ashtu, mungon edhe presioni nga lojtarët e rëndësishëm joqeveritarë.

- **Prioritete tjera urgjente**

Qeveria dhe publiku dëshirojnë të fokusohen mbi çështjet jetike si dhe rimëkëmbjen menjëherë pas shkatërrimeve të gjëra.

- **Kapacitete të pamjaftueshme**

Ekziston mungesa e burimeve dhe strukturave themeltare institucionale për të përkrahur një proces formal në kërkim të së vërtetës.

- **Mekanizmat alternativë apo përparësitë**

Kultura lokale kombëtare nganjëherë anashkalon krimet e së kaluarës apo nganjëherë në kuadrin e shoqërive ekzistojnë edhe mekanizmat që mund të adresojnë në mënyrë më të mirë dhunën e paradokohshme. Këto të gjitha mund të jenë arsye që shoqëritë në tranzicion përmbahen nga një procesi zyrtar të kërkimit të së vërtetës dhe thonë se është e mirëseardhur që me këto të merren mekanizmat joqeveritar për kërkim të së vërtetës. Kjo, pa dilemë, do të jetë një vendim i vështirë, sidomos nëse numër i madh i viktimave kërkojnë themelimin e komisionit për të vërtetën. Natyrisht, duhet të trajtohet me skepticizëm çdo vendim për anashkalimin e procesit të përcaktimit të së vërtetës në rrugë zyrtare i cili është marrë pa apo me konsultime të pakta publike, apo nga palët që janë të interesuara për parandalimin e hulumtimeve të së kaluarës.

1.3. Rreziqet potenciale

- **Motivet pa vend**

Edhe në raste kur komisione për të vërtetën themelohen, nuk ka siguri se ato janë ngritur me motive të drejta dhe me vend apo që ato do t'i arrijnë shumë nga përparësitë që u diskutuan më lartë. Për shembull, mund të ndodhë që qeveria të konsiderojë komisionin për të vërtetën si mjet për zbatimin e hakmarrjes politike apo si rrugë për të deleguar përgjegjësinë e saj te të tjerët për detyrën e vështirë të cilën nuk është në gjendje të kryej vetvetiu. Ajo qëllimisht do të mund të bënte komisionin e dobët dhe në këtë mënyrë të sfidojë apo refuzojë gjetjet e tij. Autoritetet cinike mund të ngrenë komision për përcaktimin e vërtetës për të kaluarën me qëllim të izolimit të tyre nga kritika e viktimave se nuk është bërë mjaft për të adresuar abuzimet e të drejtave të njeriut në të kaluarën.

- **Anshmëria**

Anëtarë të komisioneve mund të inkuadrohen në punën e komisioneve me paragjykime dhe anshmëri që do ta bënin të pamundur qasjen objektive dhe një llogaridhënie komplete.

- **Pritjet joreale**

Komisionet duhet të jenë të kujdesshme që nuk guxojnë të inkurajojnë pritjet jorealiste nga ana e viktimave apo publikut përgjithësisht, të cilat do të mund të çonin nga rishfaqja e nervozizmit dhe shqetësimeve shtesë te viktimat. Në thelb, eksperienca e deritanishme tregon se tepër pak komisione vuanin nga dy rreziqe të mundshme që përmenden më herët. Atje ku ekziston një shoqëri e fuqishme civile si dhe media të pavarura dhe të fuqishme, shumë nga këto rreziqe do të mund të zbutën me anë të presionit publik. Asnjëri nga këto rreziqe nuk është i pakalueshëm. Sido që të jetë, në shumë shoqëri kalimtare as shoqëria civile dhe as media nuk janë veçanërisht të fuqishëm. Si konsekuencë, këto rreziqe duhet të kuptohen paraprakisht nga ata që me mirëbesim do të angazhoheshin për ngritjen e komisioneve për të vërtetën.

2. Konteksti politik

Për faktin se komisionet për të vërtetën krijohen gjatë tranzicioneve politike, ekziston një varg faktorësh që limitojnë apo favorizojnë ngritjen dhe operacionet e tyre.

2.1. Faktorët kufizues

Faktorët kufizues mund të jenë të theksuar atje ku për procesin e tranzicionit nuk ka konsensus të gjerë shoqëror, edhe pse ata mund të jenë pak a shumë të pranishëm edhe në proceset që shquhen për konsensus të të gjithë faktorëve. Shumë procese kalimtare janë rezultat i negociatave të hidhura dhe varen nga amnistia apo “pushtet të limituar” të regjimeve aktuale si çmim për sigurimin e kontrollit në vend. Është e zakonshme që në këso raste të paraqitet shkatërrimi masiv i evidencës për krime nga regjimi i kaluar. Po ashtu, mund të jetë e pranishme edhe droja legjitime për të dëshmuar (përfshirë kërcënime dhe frikësime private kundër dëshmitarëve) që në mënyrë të konsiderueshme mund të dëmtojnë mundësinë e komisioneve për të vërtetën dhe t'i detyrojnë ato të kthehen në një proces privat dhe në disa raste i mbyllur, në vend që të ushtrohet një proces i hapur dhe publik. Korrupsioni apo administrata e dobët gjyqësore si dhe mungesa e bashkëpunimit nga ana e policisë mund të bëjnë nga komisioni “një tigër prej letrës”, ngaqë komisionet varën në shumë mënyra nga përkrahja dhe bashkëpunimi i faktorëve kryesor në institucionet që e administrojnë drejtësinë. Së fundi, ngritja dhe veprimi i komisionit mund të jetë i minuar në ato raste ku ka një identifikim të gjerë dhe më i madh social me kryerësit e veprave sesa me viktimat apo atje ku ka brenga të gjëra shoqërore për mundësinë e pengimit të procesit të demobilizimit, çarmatimit dhe integritit.

2.2. Faktorët favorizues

Faktorët favorizues kanë tendencë të jenë të fuqishëm ku procesi i tranzicionit është relativisht i lirë dhe konsensual, edhe pse ata, gjithashtu, mund të jenë të pranishëm në shkallë të madhe apo të vogël edhe në tranzicione të kufizuara. Faktorët në vijim janë sidomos të rëndësishëm:

- përkrahja publike për themelimin e komisionit të së vërtetës; pranie a shoqërisë së inkuadruar dhe energjike civile (sidomos grupe të fuqishme të viktimave, grupe për të drejtat e njeriut, liderët fetarë dhe inteligjencia);
- identifikimi i gjerë social me viktimat të abuzimit; media e pavarur dhe e zëshme; dhe
- vëmendja dhe presioni permanent ndërkombëtar.

Në mungesë të këtyre faktorëve, komisioni për të vërtetën do të mund të jetë i padobishëm, i padëshirueshëm dhe pa efekt. Me siguri se “pronësia” publike mbi këtë proces dhe pjesëmarrja aktive e disa sektorëve vendimtare sociale (vendore dhe ndërkombëtare) përbëjnë mëlbresa kritike në sigurimin e një komisioni të suksesshëm.

3. Sponzorimi

Komisionet për të vërtetën mund të krijohen në njërin nga rrugët në vijim:

- dega ekzekutive e pushtetit adopton vendimin për ngritjen e komisionit;
 - dega legjislative e pushtetit adopton ligjin për autorizimin e themelimit të komisionit;
- apo

- qeveria dhe opozita e armatosur nënshkruajnë një marrëveshje duke autorizuar themelimin e komisionit (ku mund të ketë apo të mos ketë vendim apo legjislacion për këtë).

Në shumë vende, mënyra për themelimin e komisionit për të vërtetën do të ketë efekt në kualitetin e autorizimeve të saj. Për shembull, në vende demokratike me sisteme presidenciale apo gjysmë presidenciale të qeverisjes, dega ekzekutive e qeverisjes zakonisht nuk mundet të përcaktojë dhe të ndaj autorizime dhe pushtete të veçanta, kjo ka tendencë të bëhet e drejtë ekskluzive e degës legjislative të qeverisjes. E njëjta gjë vlen edhe kur bëhet fjalë për të drejtën e raportimit, përfshirë edhe çështjen nëse komisioni mund të bëjë rekomandime të obligueshme. Në mënyrë të ngjashme, ai që e themelon komisionin do të mund të ndikojë edhe në financimin e tij, nëse dihet se ajo degë e qeverisjes e cila ka qasje më të madhe ndaj burimeve ka edhe zotime më të mëdha ndaj punës së komisionit.

4. Projekt – konstruksioni

Disa nga çështjet parimore që lidhen me themelimin e komisionit për të vërtetën janë:

- procesi i përzgjedhjes për një kompozim përfundimtar i komisionit;
- përcaktimi i mandatit dhe i pushtetit të komisionit; dhe
- vendimet për burime financiare dhe njerëzore.

4.1. Përbërja e komisionit

Ndoshta si asnjë faktor tjetër i veçantë, individë të zgjedhur që të menaxhojnë komisionin e së vërtetës do të përcaktojnë suksesin apo dështimin e tij përfundimtar. Në të vërtetë, disa komisione kanë përjetuar probleme serioze që buronin qartazi nga menaxhimi i dobët i prijësve të tyre. Edhe pse anëtarët e komisionit nuk janë të inkuadruar në administrimin ditor të komisionit, ata zakonisht i drejtojnë hetimet, e përcaktojnë politikën e komisionit dhe e kanë fjalën e fundit lidhur me atë se çfarë do të shkruante në raportet e tyre. Si fytyra e vërtetë e komisionit, autoriteti personal dhe politik i komisionarëve mund të jetë po ashtu kritik në ballafaqimin me autoritete të padëgjueshme.

Anëtarët e komisioneve të deritanishme janë emëruar me anë të procedurave që mbështeteshin mbi vlerësime të qëlluara të autoriteteve që bënin emërimet dhe pa apo konsultime të pakta me shoqërinë civile. Ky ishte rast në Argjentinë, Çad, Kili, Haiti dhe Uganda. Viteve të fundit, ndërkaq, përzgjedhja e anëtarëve të komisionit është kryer në mënyrë shumë më kreative dhe konsultative. Mësimi vendimtar nga eksperiencia e komisioneve e kaluara për të vërtetën është që këto komisione do ta gëzonin përkrahjen më të gjerë të publikut si dhe atë ndërkombëtare kur anëtarët e tyre janë përzgjedhur me anë të një procesi seleksionues dhe konsultues dhe ku përpjekja më e sigurtë konsiston në balancimin e drejtë në përfaqësimin e opinioneve politike, etnike, religjioze dhe gjinore.

Një shembull i mirë për qasjen konsultative ndaj përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit përbën rasti i TRC-së së Afrikës Jugore. Është caktuar një komitet përzgjedhës i cili përmbahej prej përfaqësuesve të grupeve për të drejtat e njeriut. Komiteti ka ftuar për nominime nga publiku dhe menjëherë ka pranuar afro 300 propozime. Këto propozime janë ngushtuar në 50 emra të ftuar për intervistë. Intervistat janë zhvilluar në sesione

publike dhe ishin të mbuluara drejtpërsëdrejti nga mediat. Komiteti përzgjedhës e ka ngushtuar më pas listën e kandidatëve në 25 emra dhe ajo iu dërgua presidentit Nelson Mendela për përzgjedhjen finale. Për të siguruar balancimin gjeografik e politik, Mendela ia ka shtuar listës edhe dy emra të kandidatëve që nuk e kaluan tërë procesin përzgjedhës. Një shembull tjetër i mirë vjen nga Sierra Leone. Statuti sipas së cilit u krijua komisioni për të vërtetën e ka autorizuar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm si koordinator për përzgjedhjen dhe i ka dhënë kompetenca për të kërkuar nga publiku që të bëjë nominime për komision. Në të njëjtën kohë, u themelua një panel përzgjedhës në të cilin u deleguan përfaqësues të opozitës së dikurshme të armatosur, të komisionit qeveritar për të drejtat e njeriut, presidentit, këshillit ndër-fetar joqeveritar dhe koalicionit të grupeve për të drejtat e njeriut. Ky panel ka intervistuar finalistët, ka bërë vlerësimin dhe gradimin e tyre, dhe më pas i ka dërguar propozimet te koordinatori përzgjedhës, i cili nga ana e tij më pas e ka bërë seleksionimin e katër kandidatëve final kombëtar (tre anëtarë ndërkombëtarë ishin zgjedhur më parë nga Komisionari i Lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut (UNHCHR). Lista e kandidatëve kombëtar dhe ndërkombëtare pastaj iu dërgua presidentit të Siera Leones për emërime. Anëtarët e komisionit u emëruan në maj të vitit 2002.

Procesi i ngjashëm konsultativ në ngritjen e komisionit të së vërtetës u zbatua edhe në Timorin Lindor.

4.2. Mandati dhe kompetencat

Çdo komision për të vërtetën deri më tash ishte unik dhe dallonte në mënyrë të rëndësishme prej komisioneve në vende të tjera. Sipas natyrës së tyre, komisionet për të vërtetën janë fleksibile dhe secili komision i ri mund të ngrihet në mënyrë e cila do t'i adresonte më së miri kërkesat specifike dhe rrethanat e vendit në të cilin do të vepronte. Edhe pse shumë do të mund të mësohet nga eksperiencia e mëparshme, përfshirë gjuhën specifike që përdoret në aktet e komisioneve të vendeve tjera, është thelbësore që çdo komision i ri për të vërtetën të themelohet nga një proces i vërtet vendor për planifikimin strategjik, si dhe nga refleksionet e nevojave dhe mundësive të çdo vendi të veçantë.

Përvoja e viteve të fundit tregon se komisionet për të vërtetën e gëzojnë legjitimitetin më të madh atje ku procesi i përcaktimit të kompetencave dhe mandatit të tyre përfshinë inkuadrimin e sa më shumë sektorëve të ndryshme të shoqërisë. Edhe pse ekziston nevoja që sa më shpejt të nisët procesi i tranzicionit, është nga rëndësia e madhe që të krijohet një bazë e gjerë e përkrahjes për komisionin në mesin e faktorëve të rëndësishëm shoqëror. Në ato vende ku qeveria ka themeluar komisionin për të vërtetën pa gati kurrfarë konsultimi të shoqërisë civile, ky komision nuk kishte rezultate të mëdha. Për shembull, në Guatemala ka kaluar një kohë e gjatë dhe u bënë shumë përpjekje derisa komisioni për të vërtetën siguroi përkrahjen e grupeve religjioze dhe atyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga të cilat ai varej për ta nisur veprimin e vetë.

Kur bëhet fjalë për përmbajtjen e mandatit të komisionit, themeluesit e tij – qoftë nga dega ekzekutive apo legjislative të qeverisjes qoftë nga palët ndërluftuese në konflikt – do të marrin në konsideratë një numër çështjesh. Në mesin e tyre më të rëndësishme janë:

- **Objektivat.**

Përshkrimi i karakteristikave të komisionit përgjithësisht duhet t'i përcaktojë objektivat e saj kryesore. Kjo mund të përfshijë, për shembull, kërkimin e vërtetës për të kaluarën,

kontributin për pajtim kombëtar, bërjen e rekomandimeve për t'i ndihmuar viktimat dhe parandalimin e rikthimit në gjendje luftë apo pushtet autoritarin.

Objektivat do të shërbenin si udhërrëfyes për punën e komisionit si dhe kriter për vlerësimin e punës së saj.

- **Periudha e përshtatjes.**

Përshkrimi i punës, gjithashtu, do të duhej të përmbanin afatet për fillimin dhe përfundimin e punës së komisionit. Këto afate mund të jenë fleksibile, duke lejuar vazhdimin e tyre në një afat të shkurtër. Sido që të jetë, periudha e përgjithshme për operacionet e komisionit duhet të jetë e përcaktuar qartë, përndryshe komisioni do të mund të zgjaste punën tepër shumë, gjë që mund të çonte nga humbja e fokusit dhe rrjedhimisht nga humbja e interesimit në publik. Eksperienca nga e kaluara tregon se korniza kohore prej 1–2 vjetësh për operime të komisioneve të tilla është përgjithësisht e dëshirueshme.

- **Llojet e dhunës që duhet hetuar.**

Përshkrimi i punës duhet të merret edhe me mënyrat e dhunës të cilat duhet të ekzaminohen nga komisioni. Natyrisht, abuzimet e të drejtave të njeriut kanë tendencë të jenë në fokusin kryesor të komisioneve të tilla. Sido që të jetë, ekziston një numër i madh si dhe shumë lloje të ndryshme të abuzimeve të të drejtave të njeriut, gjë që është tepër shumë për një komision të vetëm për tu ballafaquar me ato në një periudhë të shkurtër kohore.

Nisur nga kjo, komisioni duhet të limitohet renditjen e prioriteteve dhe ekzaminimin e atyre abuzimeve që ishin kryesore dhe më të shpeshta apo ishin të konsideruar si më serioze dhe më të dëmshme në një shoqëri të veçantë. Një renditje e prioriteteve do të mund të krijonte nervozizmin e padëshirueshëm në anën e viktimave të abuzimeve që janë përjashtuar nga mandati i komisionit. Kur ndodh një gjë e tillë atëherë është nga rëndësia thelbësore që të vendosen politikat dhe mekanizmat e tjerë publikë për t'i asistuar këto persona.

- **Periudha kohore që merret në konsideratë.**

Periudha e saktë kohore të cilën komisioni duhet të hetoj duhet të jetë e qartë që nga fillimi i punës së komisionit. Kjo zakonisht përbën aspektin më diskutueshëm të mandatit të komisionit, posaçërisht nëse ekziston ndjenja e viktimizimit në të dyja apo në të gjitha anët e konfliktit nga e kaluara. Disa komisione kanë bërë hetime dhe i kanë ekzaminuar abuzimet që kanë ndodhur në periudhën prej 30 vjetësh, përderisa disa të tjerë kanë bërë ekzaminime për periudha më të shkurtra kohore. Periudha e saktë kohore përgjithësisht do të përcaktohet në bazë të atyre periudhave në historinë kombëtare kur kanë ndodhur abuzimet më të këqija apo më të mëdha dhe rrjedhimisht kjo korrespondon me periudhën e luftës civile apo të pushtetit autoritarin. Për të anashkaluar paraqitjen e anshmërisë, është nga rëndësia e përgjithshme që periudha e zgjedhur kohore për ekzaminim të jetë konsekuente dhe jo të jetë e përthyer me qëllim fokusimin vetëm mbi periudha të posaçme në historinë kombëtare..

- **Funksionet e komisionit.**

Duhet të përcaktohen edhe funksionet kryesore të komisionit me anë të të cilave ajo do të arrinte objektivat e saj. Kjo nënkupton publikimin e mandatit, zhvillimin e hetimeve dhe të kërkimeve si dhe dërgimin e raportit final me gjetjet dhe rekomandimet. Disa komisione janë të krijuara për të identifikuar individët që janë përgjegjës për abuzime specifike; në raste të tjera komisionet përjashtohen nga “emërimin e emrave” apo u

mundësohet e drejta e heshtur që vetvetiu të marrin vendim për këtë. Kohëve të fundit, komisionet për të vërtetën janë gjithë një e më shumë të autorizuar që të mbajnë dëgjime publike. Kjo tendencë është e inspiruar gjerësisht nga eksperiencia e TRC-së në Afrikën Jugore. Në disa raste, nga komisionet për të vërtetën është kërkuar që të sigurojnë ndonjë formë të përkrahjes emocionale apo këshillimin për viktimat dhe dëshmitarët të cilët do të mund të përjetojnë trauma për shkak të rikujtimit të traumave të tyre.

- **Kompetencat.**

Nga kompetencat që i jepen komisionit varen fuqia dhe qasja e tij. Si minimum, komisioni përgjithësisht duhet të jetë i autorizuar për të ftuar për intervistë akëcilin që mund të sigurojë informacione relevante; që të llogaritet në bashkëpunim të autoriteteve publike, si dhe që të zbatohet çfarë do çoftë vizite në terren (të paparalajmëruar – që do të jetë ideale).

Por është në rritje një dukuri që komisioneve tu jepen kompetenca që janë shumë më të gjëra nga këto të përmendura, sikundër e drejta për ftesë obliguese, për kërkim dhe për zaptim, ndërkaq në disa raste edhe e drejta për mbrojtjen e dëshmitarëve. Dhënia e këtyre të drejtave duhet të jetë e balancuar me kujdes karshi nevojës që të ruhet natyra jo gjyqësore e komisioneve të tilla. Çdo kompetencë shtesë e zhvendos punën e komisionit nga kërkimi i së vërtetës drejt një procesi gjyqësor.

- **Sanksione.**

Komisioni duhet ti ketë kompetencë për të siguruar që sanksionet, sikurse gjrobat, burgosjet apo të dyja, mund tu shqiptohen akëcilin që përzihet në mënyrë të parregullt, jep informacione false apo nuk paraqitet në ftesë pa ndonjë justifikim të pranueshëm.

- **Zbatimi.**

Përshkrimi ideal i punës i komisionit do t'i parashihte obligimet e qeverisë si në publikimin e raportit final të komisionit ashtu edhe në zbatimin e rekomandimeve të tij. Një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet edhe auditimit, ruajtjes dhe përdorimit të mëtutjeshëm të materialeve dhe procesverbaleve të komisionit pasi ai i përfundon operimet.

- **Burimet njerëzore dhe materiale**

Madje edhe mandati i përcaktuar në mënyrë ideale nuk do të siguronte suksesin e komisionit për të vërtetën nëse ai ballafaqohet me mungesën e mbështetjes materiale dhe në kuadro. Kjo nuk do të thotë se komisionet për të vërtetën përbëjnë ndërmarrje të shtrenjta. Përpos komisionit për të vërtetën në Afrikën Jugore dhe në Guatemala (të dyja patën buxhetin shumëmilionësh) komisione të tilla kanë buxhet më të vogël sesa 5 milionë dollarë dhe rishtazi rreth 1 milionë dollarë. Sido që të jetë, për shkak të gjuhës gjithë një e më të sofistikuar në përshkrimin e punës së komisioneve për të vërtetën dhe po ashtu për shkak të interesimit gjithë një e më të madh të komunitetit ndërkombëtar për punën e këtyre komisioneve, një buxhet mesatar i komisioneve të tilla kap shumën 5 – 10 milionë dollarë. Ky ishte rast në komisioneve posa të ngritura apo të atyre ngritja e të cilëve planifikohet në Peru, Timorin Lindor, Gana dhe Sierra Leone. Kur bëhet fjalë për sigurimin e mjeteve, është trend që ato të sigurohen nga qeveria kombëtare, vendet donatore dhe fondacionet private. Lokalet zyrtare dhe pajisjet zakonisht sigurohen nga qeveria nacionale. Komisionet për të vërtetën në Afrikën Jugore dhe Guatemala kanë punësuar shumë më tepër staf sesa komisionet të kaluara – afro 200 pjesëtarë të stafit shumë-disiplinarë, përfshirë atë lokal dhe ndërkombëtar. Komisionet aktuale janë duke e ndjekur këtë trend edhe pse kornizat buxhetore mund të limitojnë numrin e personave të

punësuar. Në raste të tilla, komisionet mund të mbështetën në stafin të huazuar nga qeveria.

5. Komisionet për të vërtetën në veprim

5.1. Faza përgatitore

Përgjithësisht, është një ide e mirë që anëtarët e komisionit për të vërtetën t'i dedikojnë javët e para të punës së vetë pas inaugurimit të tyre përgatitjeve për fillimin nga puna. Kjo përfshinë:

- hartimin e planit për nevojat në kuadro dhe punësimi i tyre;
- përpilimin e rregullave dhe politikave të brendshme;
- adoptimin e planit të punës;
- përcaktimin dhe instalimin e një baze efektive për të dhënat, mirëmbajtjen, organizimin dhe përdorimin e tyre;
- hulumtimin preliminar të prapavijës;
- mbledhjen e dokumentacionit ekzistues nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, KB-ja, qeveritë e huaja dhe burime të tjera;
- përcaktimin e fushatës edukuese publike; dhe
- përgatitjet për sigurimin e fondeve dhe aprovimin e buxhetit.

Ndërmarrja e këtyre aktiviteteve përgatitore me kohë do të mund t'i shërbente shumë mirë komisionit në afat të shkurtër dhe atë të gjatë. Përvoja e kaluar tregon vërtet se ato komisionet që nuk kanë startuar mirë do të humbasin kohën e çmueshme dhe kapitalin politik që në vitin e parë të punës së vetë.

5.2. Aktivitetet parimore të Komisionit për të vërtetën gjatë ekzistimit të tij

5.2.1. Marrëdhënie me publikun

Marrëdhëniet me publikun të komisionit për të vërtetën janë nga rëndësia e jashtëzakonshme. Natyra dhe gjerësia e këtyre marrëdhënieve do të kenë ndikim themeltar mbi qasjen e tij ndaj informacioneve, efektivitetit të tij në adresimin e nevojave të viktimave, aftësinë e tij për të menaxhuar pritjet publike si dhe imazhin e tij të përgjithshëm në sytë të publikut. Disa nga këto aktivitete mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga komisioni me anë të mbajtjes së takimeve informative publike si dhe përmes përgatitjes, publikimit dhe shpërndarjen e doracakëve, video regjistrimeve dhe publikimeve në formë moderne për rolin dhe mandatin e komisionit. Komisioni po ashtu mund të zbatojë politikën e vetë për marrëdhëniet me publikun edhe përmes përdorimit efektiv të OJQ-ve, organizatave të njohura vendore dhe mediave. Marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe median, ndërkaq, do të mund të jenë të komplikuar për faktin se ata e luajnë rolin e dyfishtë karshi komisionit, duke punuar paralelisht si partner i tij dhe njëherësh si kritikues i procedurave dhe aksioneve të tij.

5.2.2. Marrja e deklaratave

Shumica e komisioneve për të vërtetën i sigurojnë informacionet e tyre me anë të takimeve me dyer të mbyllura dhe private, zakonisht përmes regjistrimit të dëshmimeve nga viktimat që e bënë stafi i komisionit. Ky proces quhet “marrja e deklaratave” dhe përfshin takimin dhe bërjen e deklaratës me shkrim nga deponuesi. Marrja e deklaratave është e

rëndësishme për dy arsye: ajo e shtyn përpara qëllimin për përcaktimin e vërtetës për të kaluarën; dhe ajo i mundëson viktimës që të vijë dhe dëshmojë për përvojën dhe traumat e veta në një ambient miqësor dhe të sigurt. Për shkak të natyrës së ndjeshme të procesit dhe zakonisht karakterit të tmerrshëm të informacioneve që sigurohen, marrja e deklaratave kërkon staf që është në gjendje të tregoj përqendrim, respekt dhe kontroll emocionale. Kjo nënkupton një trajnim intensiv përpara se të fillohet me këtë aktivitet. Ata që i marrin deklaratat duhet të dinë kur dhe si duhet të dëgjojnë, si dhe të tregojnë respekt ndaj ritmit zakonisht të papritur dhe logjikës së memories së personave që rrëfejnë për të kaluarën.

Edhe pse mund të ekzistojë tensioni mes dëshirës që të fokusohen vetëm modeli specifik i informacioneve që kërkohet nga komisioni dhe nevojës që rrëfyesit ti lejohet që të paraqes ngjarjen nga këndi i tij apo saj, marrësi i deklaratës duhet të gjejë rrugën të godet balancimin e drejtë. Për deponuesit e deklaratave dhe dëshmitarët, marrësit e deklaratave do të jenë të vetmit me të cilët nga komisioni do të kohet kontakti dhe rrjedhimisht kjo do të krijonte përshtypjen e tyre kryesore për punën e komisionit, gjë që është shumë e rëndësishme.

5.2.3. Kërkime dhe hetime

Njësitet për kërkime dhe hetime sikurse ato policore janë duke bërë gjithë një e më shumë pjesë e komisioneve për të vërtetën. Njësitë të tilla kanë tendencë për tu bërë pjesë e komisioneve me buxhete të mëdha dhe mandate të fuqishme, sikundër në rastin e TRC-së në Afrikën Jugore. Njësitet për kërkime, nga ana tjetër, synojnë të jenë relativisht të vogla por me staf që ka aftësi të dukshme hetuese dhe është shumë i afërt me organizata joqeveritare hulumtuese kombëtare, arkivat lokale dhe burime të tjera vendimtare të informacionit. Në dallim prej tyre, njësitet hetuese mund të kenë njerëz me prapavijë dhe eksperiencë në organet për zbatimin e ligjit. Shumë komisione për të vërtetën i kombinojnë kërkime me hetime në kuadrin e një departamenti, gjë që ka shumë avantazhe.

5.2.4. Përpunimi i të dhënave

Komisionet për të vërtetën ballafaqohen me një sasi enorme të informacionit i cili duhet të organizohet dhe të sistemohet. Në mesin e gjërave të tjera, kjo kërkon një bazë të të dhënave efektive për deponim, organizim dhe shfrytëzim të dokumentacionit dhe të dhënave. Përgjithësisht, komisionet që mbledhin, rruajnë dhe analizojnë të dhëna në mënyrë rigorozë do të jenë në gjendje të mbrojnë gjetjet e tyre në mënyrë shumë më të suksesshme dhe me mbështetje shkencore. Një sistem i fuqishëm për menaxhimin e të dhënave do të ndihmonte në krijimin e “pasqyrës së gjerë” të mostrave e cila do të mund të ndihmonte, për shembull, në përcaktimin e shkallës ekzakte të abuzimeve të bëra nga një palë mbi palën tjetër. Në planin për kuadrot, komisionet duhet të punësojnë programuesin për krijimin dhe menaxhimin e programeve bazike kompjuteristike, si dhe për shfrytëzimin e tyre të lehtë për bërjen e analizave. Po ashtu, do të paraqitet nevoja edhe për analistët e statistikës (apo ata social që kanë njohuri të gjerë për metodat statistikore) për kontrollimin e të dhënave përpara se ato të publikohen, si dhe një ekip i proceduesve të të dhënave për inkuadrimit në sistem të të gjitha informacioneve të pranuar nga komisioni.

5.2.5. Dëgjime publike

Shumica e komisioneve për të vërtetën nuk mbajnë dëgjime publike. Por, ekziston një prirje e fortë që komisioneve tu jepet ky mandat. Ky është rasti te komisione të reja në Peru, Timorin Lindor dhe Sierra Leone, të përmendim vetëm disa prej tyre. Ekzistojnë arsye bindëse që komisionet të mbajnë dëgjime publike. Duke u dhënë viktimave dhe të mbijetuarve shansin që të dëshmojnë në prani të publikut – sidomos ku këto dëgjime transmetohen drejtpërsëdrejti në televizion dhe radio – komisioni ka mundësi të vërtetojë në mënyrë formale dështimet e së kaluarës, të inkurajojë kuptimin e procesit dhe simpatitë ndaj viktimave nga ana e publikut, të ngushtojë mundësinë që disa sektorë të shoqërisë të vazhdojnë me mohimin e së vërtetës, si dhe të risin transparencën e punës së vetë. Dëgjime publike, po ashtu, mund të ndihmojnë që fokusi i komisionit të kalojë nga produkti final (raporti i saj final) te procesi, duke inkadruar publikun si audiencë, duke inkurajuar angazhimin e mediave për një afat të gjatë dhe përgjithësisht duke stimuluar një qasje gjithëkombëtare ndaj së kaluarës. Komisionet për të vërtetën në Ugandë, Sri Lankë dhe Nigeri kanë mbajtur dëgjime publike, por ishte dëgjimi i TRC-së së Afrikës Jugore që pati ndikimin më të madh ndërkombëtar. Jo vetëm që atje mbaheshin dëgjime publike për qindra ditësh rresht por atje ishte e pranishme edhe një shumëllojshmëri unike në format e dëgjimit publik, përfshirë dëgjimin e viktimave, dëgjime për amnisti, dëgjime tematike e speciale (gra dhe fëmijë), dëgjime për ngjarje speciale (kryengritja studentore në Soweto), dëgjime institucionale (përfshirë struktura legale e shëndetësore) dhe dëgjimet e partive politike. Të motivuar nga shembulli i fuqishëm i Afrikës Jugore në Afrikën Jugore, një numër i analistëve ka rekomanduar që të gjitha komisionet për të vërtetën të mbajnë në të ardhmen dëgjime publike. Por, mund të ekzistojnë arsye legale për mosmbajtjen e dëgjimeve publike, përfshirë sigurinë e anëtarëve të komisioneve dhe viktimave, si dhe për shkak të kushteve apo kufizimeve kohore, brengës për shndërrimin e procesit në gjykim. Në të njëjtën kohë, procedime publike për të vërtetën janë potencialisht po ashtu mjaft të fuqishme për tu marr në konsideratë nga të gjitha komisionet.

5.2.6. Përkrahja emocionale

Komisionet për të vërtetën në një farë mënyre e përmbushin nevojën e disa viktimave që të rrëfihen, të dëgjoen dhe të shërohen në një farë mënyre. Por, për disa të tjerë procesi do të mund të përbënte rikthimin e traumës si dhe krijimin e efekteve të tjera të rënda dhe negative. Komisionet për të vërtetën në të kaluarën nuk i kanë dhënë shumë rëndësi kësaj çështjeje, por kjo ka nisur tani të ndryshoj. Për shembull, Komisioni për të Vërtetën në Afrikën Jugore ka punësuar katër profesionistë për shëndetin mental, ka siguruar trajnime për stafin që ishte paraparë të jepte këshillime për persona të traumatizuar dhe ka punësuar të ashtuquajturit “briefers”, detyra e të cilëve ishte që të sigurojnë përkrahjen konstante atyre që kanë dëshmuar në dëgjime publike. Duhet cekur se edhe vetë stafi i komisioneve do të mund të traumatizohet gjatë procesi dhe do të mund të ndjente nevojë për ndihmë dhe përkrahje emocionale. Në shumë shoqëri, standardet për këshillime psikike do të mund të jenë të papërshtatshme për ndihmën e viktimave, qoftë për shkak të arsye kulturore qoftë për shkak të limiteve në burime. Burimi ideal për përkrahje në disa vende do të mund të ishte bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë, shëruesit tradicional, institucionet religjioze dhe grupet për vetë-përkrahjen.

5.2.7. Raporti final

Çasti kryesor për çdo komision të së vërtetës zakonisht është kompletimi dhe publikimi i raportit të tij final. Raportet finale zakonisht përbëjnë porosinë përfundimtare të komisionit dhe ajo përdoret si burim për edukim në fushën e të drejtave të njeriut dhe procedime të mëtutjeshme në kuadrin e gjyqësorit. Nëse këto raporte janë të dokumentuar mirë dhe kanë koherencë metodologjike, ato do të mund të shërbejnë si një mbrojtës i fuqishëm kundër revizionizmit. Në shumë mënyra, ndikimi i raporteve finale varët më pak nga përmbajtja e tij sesa nga një sërë faktorësh përreth, përfshirë kohën dhe mënyrën e publikimit të raportit, gjerësinë e shpërndarjes së tij, mbulimin e tij nga mediat si dhe mënyra e prezantimit të tij në mënyrë tradicionale dhe alternative. Edhe pse përmbajtja dhe formati i raporteve finale dallojnë njëri nga tjetri, raportet finale zakonisht përmbajnë pjesën mbi gjetjet dhe atë me rekomandimet. Seksioni me gjetjet e shtruar zakonisht identifikon arsyet dhe mostrat e dhunës në të kaluarën, si dhe viktimat e kësaj dhune. Në disa raste, mund të raportohet edhe përgjegjësia individuale apo ajo institucionale për abuzimet – praktikë kjo që është ekzaminuar më gjerësisht në seksionin e më poshtëm *Shpalosja e emrave dhe procesi i mëtutjeshëm*. Ekzistojnë nganjëherë tensione mes anëtarëve të komisionit rreth qasjes empirike apo legale në qasjen e raportit final. Në vazhdim të gjetjeve në raport, komisionet për të vërtetën zakonisht bëjnë rekomandimet që shkojnë nga sigurimi i asistencës apo dëmshpërblimi i viktimave, ndryshimi i nevojshëm i reformave kushtetuese, ligjore dhe institucionale për të evituar rënie të serishme në luftë në të ardhmen apo kthimin e pushtetit autoritarin, si dhe krijimin e premisave themeltare për konsolidimin e demokracisë dhe pushtetin e ligjit. Në shumë raste, komisionet kanë bërë po ashtu rekomandimet për masa të mëtutjeshme për të siguruar implementimin efektiv dhe me kohë të rekomandimeve. Fatkeqësisht, evidenca për implementimin e rekomandimeve të komisioneve të deritanishme nuk është shumë inkurajuese.

5.2.8. Shpallja e emrave dhe procesi i mëtutjeshëm

Një numër komisionesh për të vërtetën kishin kompetencë për të publikuar emrat e atyre individëve që ishin përgjegjës për krimet mbi të drejtat e njeriut. Kështu vepronin komisionet në El Salvador, Çad dhe Afrikën Jugore. Komisione të tjera nuk kanë gëzuar këtë të drejtë në mënyrë të theksuar por kanë gjetur rrugë dhe mënyra për të publikuar emrat e individëve. Për shembull, disa komisione kanë identifikuar në mënyrë të suksesshme abuzuesit individual duke publikuar citate të drejtpërdrejta të dëshmitarëve apo viktimave në të cilat përmendeshin emrat e abuzuesve, apo përmes identifikimit të drejtpërdrejt të atyre që ishin në krye të njësitit apo rajonit të veçantë ku dhuna sidomos ishte shfaqur dhe rrjedhimisht kanë mundësuar identifikimin e tyre të lehtë. Në raste të tjera, përcaktimi i përgjegjësive individuale është mundësuar përmes dhënies së qëllimshme apo të fshehtë të të dhënave për këta individë mediave.

Shumë pak nga çështjet nga puna e komisioneve për të vërtetën kanë hasur në kundërthënie sikundër kjo ishte rast me “shpalosjen e emrave”. Kjo çështje ende mbetet një burim tensionesh për ata që gjenden përpara ngritjes së komisioneve të reja. Bëhet fjalë për konfrontimin e dy parimeve themeltare që kanë shumë përkrahës dhe argumente në të dy anët. Parimi i parë thotë se individëve të akuzuar për krime duhet tu sigurohet që të mbrohen përpara se të shpallën fajtor. Rrjedhimisht, procesi i së vërtetës dëmtohet nëse komisioni, i cili nuk është as gjykatë dhe as nuk ushtron të njëjtat procedura, përcakton

dhe shpall emra e individëve të përgjegjshëm për krime konkrete. Parimi tjetër thotë se përcaktimi i vërtetës kërkon që të shpallen emrat të atyre që janë përgjegjës për krimet kundër të drejtave njerëzore nëse ekziston evidenca e qartë për fajin e tyre. Rrjedhimisht shtrohet pyetja: Çfarë standardesh dhe procedurash procesi i gjetjes së vërtetës duhet të aplikojë ndaj personave që do të mund të përmenden në raport? A duhet informuar ata për akuzat kundër tyre si dhe për synimin e komisionit që të shpall emrat e tyre në raportin publik? A duhet ata të kenë mundësi të që të reagojnë ndaj evidencës kundër tyre dhe të ofrojnë mbrojtje? A duhet komisioni të thotë qartazi se bëhet fjalë për përfundimin e vetë tij dhe se ai nuk përfshinë edhe përgjegjësinë penale? Të gjitha këto janë çështje me të cilat komisionet duhet të ballafaqohen. Eksperienca e deritanishme tregon se praktika më e mirë është që komisioneve tu lejohet mundësia që t'i shpallin emrat dhe tu lihet mundësia që vetë të vendosin nëse duhet të shpallin emrat apo jo. Kjo sepse mund të ekzistojnë një numër arsyesh ligjore për të mos shpallur emrat, sikurse rreziqet e sigurisë për anëtarët e komisionit, viktimat apo dëshmitarët apo mungesa e evidencës së mjaftueshme për gjykimin publik të një individi.

Nëse komisioni vendos që të mos shpallë emrat e abuzuesve, atëherë të paktën duhet të kërkohet nga ai që t'i numëroj arsyet për këtë dhe arsyet për këtë duhet të jenë të arsyeshme nga këndi politik, moral dhe ligjor. Atje ku komisioni vendos që të shpalosë emrat, ai duhet të thotë qartazi se gjetjet e tij nuk përcaktojnë përfundimisht fajin e dikujt penal apo ligjor. Për sa u përket procesit të shpalljes së emrave të përgjegjësve, duket se komisionet të paktën duhen në këto raste (a) të njoftojnë personin në fjalë pa asnjë vonesë për deklaratat akuzuese kundër tij dhe synimin që ato të shpallen në raportin publik, si dhe (b) të krijojnë mundësinë për këta persona të reagojnë ndaj evidencës dhe provave kundër tyre dhe të ofrojnë mbrojtje, por jo domosdoshmërisht me anë të një dëgjimi publik. Në mesin e të drejtave shtesë për këta persona, ato sikundër siguri i këshillimit – mbrojtjes apo mundësia e bërjes së pyetjeve të drejtpërdrejta ndaj dëshmitarit, duhet të sigurohen vetëm në raste të jashtëzakonshme. Si një rregull e përgjithshme, është e panevojshme dhe e padëshirueshme që komisionet të ngarkohen me obligime ekuivalente me atyre të gjykatës. Një ngarkesë e tillë do të minonte seriozisht aftësinë e komisionit të zbatojë obligimet e tij esenciale sepse do ta ngadalësonin në mënyrë të konsiderueshme procesin hetimor dhe dëgjimor, duke ngurtësuar kapacitetin e komisionit që të mbledh fakte dhe evidencë dhe duke e kthyer procesin e komisionit në atë gjyqësor. Kjo nuk do të thotë se komisionet duhet të sakrifikojnë të drejtën e abuzuesve në interes të viktimave. Thjesht, lypset një balancim racional ndërmjet interesit reciprok të drejtësisë në një anë dhe efikasitetit në anën tjetër.

5.2.9. Sfida e përfshirjes së fajtorëve në proces

Një nga paqartësitë më të mëdha të komisioneve për të vërtetën në të kaluarën përbënte pamundësinë e tyre që t'i inkuadrojnë në mënyrë të kuptimshme dhe të sigurojnë bashkëpunimin e fajtorëve potencial pa marr parasysh nëse ata ishin nga policia, ushtria, shërbimet informative apo të ndonjë mekanizmi tjetër represiv. Një përjashtim domethënës (dhe kontradiktor) përbën TRC-ja e Afrikës së Jugut e cila kishte kompetenca për të dhënë amnisti individuale për ata që dyshoheshin si fajtor apo për krime të motivuara politikisht. Amnistia u është dhënë atyre që pranuan tërësisht involvimin e tyre në krimet e së kaluarës që ishin politikisht të motivuara. Për krime veçanërisht serioze, këta persona duheshin të paraqiteshin në dëgjime publike për të

pranuar fajin apo për tu përgjigjur në pyetje. Disa qindra pjesëmarrës të krimeve apo abuzimeve të të drejtave të njeriut kanë ardhur për të shpalosur përzjerjen e tyre apo njohurit e tyre për krimet e së kaluarës që ishin në agjendën e komisionit. Natyrisht, shfrytëzimi i formulës “amnistia në këmbim të së vërtetës” si një nga rrugët për të siguruar bashkëpunimin e fajtorëve hap çështje të vështira nga këndi moral, ligjor e politik. Amnistia përgjithësisht e abuzon të drejtën e viktimës për dëmshpërblim si dhe obligimin e shtetit që del nga e drejta ndërkombëtare për t’i ndëshkuar abuzuesit e të drejtave të njeriut në formë të krimeve. Ajo, gjithashtu, do të mund të rrëronte pushtetin e ligjit duke u lejuar vetëm grupeve të caktuara njerëzish që të anashkalojnë llogaridhënien. Ajo do të mund të minonte përpjekjen e përgjithshme dhe individuale për përndjekjen e kryerësve të ardhshëm të krimeve të tilla, si dhe të promovojë cinizmin dhe humbjen e shpresës në mesin e viktimave që ishin në shënjestër të abuzimit të të drejtave të njeriut, gjë që do të mund t’i shtynte ata që të përcaktohen për marrjen e ligjit në duart e veta dhe të ndërruarin akte të hakmarrjes individuale. Në anën tjetër, “amnistia në këmbim të së vërtetës” do të jetë shumë më e arsyeshme nëse: (a) vendimet e komisionit janë dhënë në mënyrë të kuptueshme demokratike; (b) amnistia është aplikuar në baza individuale e jo ato grupe apo klasore; (c) pranuesit e amnistisë janë detyruar që të inkuadrohen në një formë të procedurës publike; (d) viktimave u është ofruar mundësia që të bëjnë pyetje dhe të sfidojnë kërkesat individuale për amnisti; dhe (e) janë kryer pagesat për dëmshpërblimin e viktimave. Gjerësia e amnistisë, po ashtu, mund të kanalizohet edhe me mundësinë që dhënia e amnistisë do të mund të rishqyrtohet nëse themelohet ndonjë komision i ri për vepra të reja apo të ngjashme.

Deri më tani, vetëm Afrika Jugore e ka aplikuar formulën “amnistia në këmbim të së vërtetës”. Ky shembull mund të kopjohet vetëm me kujdes të madh dhe nëse ekzistojnë rrethanat detyruese. Së pari, nëse ekziston mungesa e kërcënimit real për përndjekje nga ana e drejtësisë (faktor ky që është tepër radhë i pranishëm në shoqëritë e tranzicionit) është pak e pritur që kryerësit e veprave do të ndjehen të detyruar që të aplikojnë për amnisti. Ata me siguri se do të rekomandonin të qëndrojnë në hije duke anashkaluar çdo rrezik për hakmarrjen e shoqërisë apo shndërrimin në shënjestër të publikut. Së dyti, do të mund të ekzistojë një sërë të mekanizmave tjerë për të inkurajuar kryerësit për tu paraqitur që mund ti shërbejnë më mirë qëllimit për të vërtetën dhe pajtimin dhe që mund të jetën shumë më tepër parimore dhe praktike se sa shpërblim me amnisti. Për shembull, komisionet mund të ofrojnë mekanizmat për dhënien e dëshmimeve në baza anonime dhe të fshehta, ato mund të përdorin kompetencën për thirrje të obligueshme ose ato mund të jenë të autorizuara që të sigurojnë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ndërrimin e vendbanimit të tyre. Një mundësi tjetër është që sponsorët e komisionit mund të përcaktojnë vepra të reja ndëshkuese për anashkalimin nga ana e dëshmitarëve të obligimit të paraqiten përpara komisionit me informacione për krimet e së kaluarës. Asnjë nga këto alternativa nuk do të çonte me domosdoshmëri drejt bashkëpunimit të gjerë me kryerësit e veprave apo dëshmitarët hezitues. Por, sido që të jetë, pa ta bashkëpunimi virtualisht do të jetë i pamundshëm.

5.2.10. Aktiviteti pas publikimit të raportit

Detyra për zbatimin e raportit dhe rekomandimeve të tij kalon në organe kompetente një herë kur komisioni e përfundon punën. Fatkeqësisht, implementimi i rekomandimeve ka qenë deri më tash sfida kryesore e komisioneve për të vërtetën, edhe kur ekzistonte

obligim ligjor për ndonjë segment të qeverisjes për implementimin e tyre (sikurse në rastin e El Salvadorit). Njëra nga arsyet kryesore për moszbatimin e rekomandimeve duket se ka qenë mungesa e vullnetit politik; por edhe kur ekzistonte vullneti i mjaftueshëm politik nuk ekzistonin kapaciteti institucional apo fonde për një detyrë të tillë. Pa marr parasysh shkakun, është nga rëndësia vendimtare që komisionet për të vërtetën të rekomandojnë edhe mekanizmat që do të mund të siguronin një monitorim të mirëfilltë dhe përcjelljen e implementimit të rekomandimeve. Nganjëherë komisionet për të vërtetën kanë fat sepse plani për zbatimin e rekomandimeve të tyre është inkorporuar në mandatin e tyre, sikundër ishte rasti në Sierra Leone. Por për shumicën, sistemi i përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve duhet të rekomandohet veçanërisht. Në Kili, komisioni i atjeshëm për të vërtetën ka rekomanduar krijimin e komisionit publik i cili kishte për detyrë të vazhdonte me disa nga punët e tij dhe të krijonte kushtet për masa të dëmshpërblimit. Në Guatemala, komisioni ka rekomanduar institucionin Fondacion për Paqe dhe Harmoni (Fundación por la Paz) për të implementuar drejtpërsëdrejti disa rekomandime dhe për të monitoruar implementimin e disa të tjerëve.

Vërejtjet përfundimtare

Përshkrimi i deritanishëm ka synuar që të shpjegonte në rrugë praktike çfarë është komisioni për të vërtetën, si ai operon dhe çfarë do të mund të ishte arritje që ai do të mund të ofronte për vendin e tij. Lidhur me këtë, është shprehur skepticizëm me aftësinë për ngritjen e një komisioni universal të së vërtetës dhe kontributin e saj që përmes kërkimit të së vërtetës të kontribuojnë në pajtimin gjithëpërfshirës. Sido që të jetë, është me rëndësi të theksohen kontribute pak të njohura por të shkëlqyeshme që komisione të tilla kanë bërë kohë pas kohe. Në Kili, për shembull, duke u bazuar tërësisht në gjetjet e komisionit, shteti ka nisur një program të gjerë të dëmshpërblimit për shumë viktime nga era e Pinochet-it. Pas hetimeve të komisionit për të vërtetën në El Salvador janë iniciuar reforma në sistemin e drejtësisë. Në Afrikën Jugore, vetëm një numër i vogël njerëzish sot ende do të mbronin apo do të justifikonin sistemin e aparthejdit, apo do të vënin pikëpyetjet mbi praktikën brutale që e kishte ushtruar regjimi i aparthejdit. Komisioni për të vërtetën është vetëm një nga shumë mekanizma që janë në dispozicion të vendeve në tranzicion të cilat janë duke synuar konsolidimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe pushtetit të ligjit. Forma të tjera për një program të plotë për drejtësinë në tranzicion përfshijnë edhe gjykime, rishqyrtime kritike të së kaluarës, reforma ligjore, si dhe masa të rikthimit dhe riintegritit. Duket se është në vijim e sipër paraqitja e trendit të ri që shkon nga integrimi apo sinteza e elementeve të ndryshme të drejtësisë në tranzicion. Kjo do të mund të shihet në vendet sikundër Sierra Leone (ku komisioni për të vërtetën dhe gjykata vendore – ndërkombëtare për krime do të funksiononin së bashku njëra me tjetrën), Ruanda (ku sistemi i ri *gacaca* synon të integrojë qëllimet e prokurorisë me kërkimin e së vërtetës dhe riintegrimin e komunitetit), Timorin Lindor (ku komisionet për të vërtetën do të shërbejnë në krijimin e kushteve për kthimin e refugjatëve, procedimin e krimeve serioze dhe kthimin e riintegrimin për vepra më pak serioze). Ekzistojnë shumë sfida dhe komplikime në përpjekje për t'i integruar e bashkuar qëllimet e tranzicionit dhe mekanizmave ekzistues për këtë rrugë, si dhe në krijimin e opsioneve kreative dhe origjinale. Qartazi, tregimi i plotë mbi komisionet për të vërtetën ende mbetet të shkruhet.